



VENDIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT PËR SHQYRTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Data e miratimit: 11 janar 2017

Numri i lëndës: 2014-18

Fitim Maksutaj

kundër

EULEX-it Kosovë

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 11 janar 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora AARNIO, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. VENDIMI I PANELIT I DATËS 12 NËNTOR 2015

1. Me 12 nëntor 2015, Paneli ka marrë vendimin pasues rreth ankesës së paraqitur nga Fitim Maksutaj me 19 mars 2014:

“Paneli, njëzëri:

1. Shpall ankesat lidhur me procedurat penale të ndërmarra nga EULEX-i ndaj ankuesit në mes të janarit 2009 dhe 15 dhjetorit 2014, të pranueshme;
2. Konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
3. Shpall se në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, Paneli gjen të përshtatshme që të bëjë rekomandime për ShM-në, dhe

REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME KORRIGJUESE:

- ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që i atribuohen veprimeve dhe/ose mosveprimeve të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv;
- ShM-ja duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të shqyrtoj se çfarë hapash mund të ndërmerren nga zyra e kryeprokurorit të EULEX-it (ZKPE) për të siguruar që lëndët nën autoritetin e kësaj zyre trajtohen në përputhje me dispozitat e nenit 6(1) të Konventës dhe që ekziston një mekanizëm efektiv shqyrtues për të siguruar që të gjitha rastet e tilla trajtohen brenda një afati të arsyeshëm. Në lidhje me këtë, Paneli tërheq vëmendjen në faktin se kur kjo lëndë ishte shqyrtuar nga ana e ZKPE-së, lënda kishte përfunduar shpejtë.

II. INFORMATA NGA ShM-ja e EULEX-it

2. Me 21 janar 2016, ShM-ja ka deklaruar se në lidhje me rekomandimin e dytë të Panelit, rasti në fjalë asnjëherë nuk kishte qenë nën autoritetin e Zyrës së kryeprokurorit të EULEX-it (ZKPE). Ai ka thënë se ZKPE-ja kishte vetëm funksione të kufizuar karshi sistemit ligjor të Kosovës, (pra atë që është e paraparë me nenin 32 A të Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit) dhe për pjesën tjetër, është një zyre e brendshme e Misionit, veprimet e të cilës nuk kanë ndikim në sistemin gjyqësor të Kosovës.
3. Ai ka thënë se në fakt si të tilla nuk ka raste nën kompetencën e ZKPE-së. Prokurorët që punojnë në ZKPE janë të vendosur në zyrat përkatëse të Prokurorisë së Kosovës, përkatësisht në Zyrën e Prokurorisë së Apelit dhe Zyrën e Prokurorit të Shtetit, dhe nuk kanë kompetenca personale t'i menaxhojnë rastet që bien nën kompetencë të zyrave të tjera.
4. ShM-ja më tej ka thënë se rasti në fjalë nuk ishte një rast që ka hyrë në kuadër të kompetencave të prokurorëve të EULEX-it, sipas nenit 1.A.1 ose nenit 7 A të Ligjit mbi Kompetencat, siç është ndryshuar në vitin

2014. Nisma e ZKPE-së në këtë rast ishte masa e fundit për shkak të faktit se zyra e prokurorisë së EULEX-it që kishte trashëguar funksionet e tij ishte shpërbërë në tetor të vitit 2014 dhe prokurorët që në atë kohë kanë punuar ose ishte dashur të punonin në këtë rast vetëm se ishin larguar nga Misioni.

5. Prandaj thjeshtë nuk ka pasur kompetencë nga autoriteti prokurorial i EULEX-it që të trajtohet ankesa e ngritur nga ankuesi. Kështu që nisma e ZKPE-së, edhe pse e frymëzuar nga një shqetësim lidhur me shkelje të mundshme të të drejtave të ankuesit, nga pikëpamja ligjore ishte menaxhimi i një rasti që ishte përtej kompetencave.
6. ShM-ja gjithashtu ka deklaruar se Misioni ishte duke e shqyrtuar se si t'i zbatonte standardet në fuqi për shqyrtimin e rasteve të trajtuara nga prokurorët e EULEX-it.

III. INFORMATA NGA ANKUESI

7. Me 22 janar 2016 ankuesit iu është dhënë një kopje e letrës nga ShM-ja që ishte e datës 21 janar 2016 lidhur me veprimin e ndërmarrë nga ShM-ja në zbatimin e rekomandimeve të Panelit. Ankuesi nuk i ishte përgjigjur kësaj letrë e as nuk kishte komentuar mbi veprimet e ndërmarra nga ShM-ja.

IV. VLERËSIMI NGA PANELI

8. Paneli vëren hapat e ndërmarra nga ShM-ja për t'i zbatuar rekomandimet e tij, posaçërisht që Misioni për momentin ishte duke shqyrtuar se si t'i zbatonte standardet efektive në fuqi për shqyrtimin e rasteve të trajtuara nga prokurorët e EULEX-it.
9. Megjithatë, Paneli më tej thekson se ShM-ja nuk ka bërë deklaratë, të ndonjë forme, për të pranuar se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje e të drejtave të ankuesit që i ishin ngarkuar veprimeve të EULEX-it Kosovë.
10. Pas shqyrtimit të informacionit të dhënë nga ShM-ja lidhur me zbatimin e rekomandimeve,

PANELI NJËZËRI

Deklaron se ShM-ja ka zbatuar rekomandimet e tij në këtë rast vetëm pjesërisht,

Vendos të mbyllur shqyrtimin e këtij rasti.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese